



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. 35-2b1-27458/2018
Dt.26.09.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010), nenit 12 dhe 17 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 1, pika (p), Neni 17 pika ”b”, Neni 55, pika “m” të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe kërkesës nr.ref. 120/IKMN/2018, të datës 22.01.2018 nga Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2018 pas diskutimit në pikën e 7 të rendit të ditës të Ndryshme, lidhur me rekomandimin e MAPL-së dhe MMPH-së për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimeve për shpalljen nën mbrojtje si monumente të natyrës nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR

MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS “TRUNGU I BUNGUT (*Quercus petraea*)” NË BEC TË GJAKOVËS NË KATEGORINË MONUMENT I NATYRËS

Neni 1

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës “TRUNGU I BUNGUT (*Quercus petraea*)” në fshatin Bec të Gjakovës, Monument i Natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monument i Natyrës).
2. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 10 m. rreth projeksonit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 500 m².
3. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tille është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Gjakovës
4. Lartësia e tringut e Monumentit të Natyrës është rreth 22 m, perimetri i kërcellit është rreth 3.5 m, diametri i kurorës rreth 12 m dhe vjetërsia është mbi 200 vite.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në brenda kompleksit të Kishës Katolike të fshatit në Bec, Ngastrën nr. 70705005-00299-0, njësia kadastrale Bec, me sipërfaqe 9065m², e regjistruar si kullosë e klasës 3, në pronësi të Kishës Katolike- Bec- KK të Gjakovës.

Neni 3

1. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i kategorisë së III-të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
2. Në Monumentin e Natyrës ndalohe:
- 2.1. Prerja e tringjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo frutave, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme natyrore,
- 2.3. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,
- 2.4. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,

- 2.5. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
 - 2.6. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur
 - 2.7. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
 - 2.8. Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.
3. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
- 3.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 4

1. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohe:

- 1.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
- 1.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
- 1.3. Ndërrimi i kulturës,
- 1.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të Natyrës.

2. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

Neni 5

1. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, është përgjegjëse Komuna e Gjakovës.
2. Personi fizik apo juridik është përgjegjës që:
 - 2.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
 - 2.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat monumentit të natyrës mund të shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
 - 2.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të monumentit të natyrës, në pajtim me legjislacionin në fuqi për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Neni 8

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit

